## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE TË KOSOVËS ( AMKMK )**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **253-21-5828-5-2-1 (AMKMK-21-032-521)**

Sa i përket tenderit për **Ekzekutimi i Punëve në projektin "Lapidari i Ylfete Humollit- Faza e II-të.**

# ANKESË

### 1. Identifikimi i ankuesit*

*N.N.T ''BURIMI'' (AGIM MORINA B.I)*
*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

*Rr. Imer Krasniqi-Malishevë*
*(Adresa)*

*Malishevë* — *20400*
*(Vendi)* — *(Kodi postar)*

*049 136 530* — _____
*(Numri Telefonit)* — *(Numri i Faks-it)*

*AGIM MORINA*
*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

*Burim.company@gmail.com*
*(Adresa elektronike)*

*23.11.2021* — _____
*(Data e parashtrimit të ankesës)* — *(Nënshkrimi dhe vula)*

Ndërmarrja Ndërtimore Transportuese N.N.T. BURIMI MALISHEVË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

_____

*(Emri i avokatit)*

_____

*(Adresa e plotë)*

_____ _____

*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

_____

*(Adresa elektronike)*

_____ _____

*(Data e parashtrimit të ankesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

B 05 Njoftim për Kontratë: 27.08.2021
B 12 Proces verbali i hapjes se Tenderve: 16.09.2021
B47 Kërkesa për sqarim: 18.10.2021
B58 Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues: 05.11.2021, ndërsa me datë: 09.11.2021(Njoftimi ne e-prokurim)
Pezollimi i AP – 10.11.2021
Kërkesa për validitet – 12.11.2021
Vendimi i AK AMKMK – 15.11.2021

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** ☐ **Jo** ☐

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po ☐ Jo ☐

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po [X] Jo ☐

| |
|---|
| *Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.* |

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

| |
|---|
| 1. Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi dhe Transparenca<br>2. Neni 59 – i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve<br>3. Neni 52, paragrafi 7<br>4. Neni 72 – i LPP – së<br>5. Neni 43 i RRUOPP-së, pika 43.1 |

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

| |
|---|
| 1. Se pari po fillojm nga e para ku me datë: 16.09.2021 kemi dorzuar oferten për AP në fjalë **(Grupi i OE: N.N.T "BURIMI(AGIM MORINA B.I) & HIDRO PRJECT SHPK** ndërsa me datë: 18.10.2021 AK na ka kërkuar sqarim lidhur me disa dokumente të cilat janë dorzuar nga ana jonë, konkretisht dokumentet me **nr.rendor 4.1.** citoj: Komisioni i vlersimit ka analizuar ofertën tuaj dhe kanë ndarë qëndrimet lidhur me këtë AP, dhe kanë kërkuar |

sqarime lidhur me ofertën tuaj. Sqarimi ka të bëjë me atë se kanë paraqitur dyshime lidhur me nënshkrimet dhe vulat në dokumentet me nr. Rendor 4.1 në ofertën tuaj si për Deklaraten në betim, marrëveshja mbi themelimin e ndërmarrjes se përbashkët "joint venture", deklaraten qe jeni bashkarishtë dhe individualisht, deklaratës se përbashkët në grup, vendimin për caktimin e menaxherit të projektit, listen e stafit, deklaratën mbi caktimin e liderit pra të gjitha dokumentet e renditura në ofertën tuaj nen piken 4.1.

Këto dokumente te listuara me lartë duhet të sillen te zyrat e AK në formën fizike-origjinale qe të verifikohen si dhe te njejtat të ngarkohen edhe në e-prokurim. ( shkres kjo e derguar nga AK. )

Ne kompania N.N.T BURIMI se bashku me anëtarin e konzorciumit HIDRO PROJECT SHPK kemi derguar dokumentet e kërkuara në formë fizike dhe origjinale ashtu si e ka kërkuar AK, gjithashtu kemi ngarkuar edhe në sistemin elektronik e-prokurimi me datë: 19.10.2021. Anëtari i grupit HIDRO PROJECT SHPK ju ka derguar e-mail menaxherit të prokurimit Besim Mulaj duke thënë se të gjitha nënshkrimet dhe vulet janë bërë me vetedije të plot nga ana e tyre, pra nga anëtari i grupit HIDRO PROJECT SHPK duke e mbeshtetur OE N.N.T "BURIMI" në pregaditjen e dokumentacionit për tender.

Pas kësaj ne jemi eleminuar me arsyetimin se: dokumentet e dorzuara nuk janë identike me dokumentet e dorzuara në ofertë, fjala është për deklaraten nën betim dhe marrveshjet e kozorciomit, konkretisht dokumentet me numer rendor 4.1

Ne i kemi dorzuar dokumentet e lartëcekura në platforemen elektronike e-prokurimi brenda afatit dhe të njetat i kemi dorzuar edhe në zyret e AK (AMKMK) ashtu siq janë kërkuar në kërkesen për sqarim, dmth në formë fizike - origjinale. Dokumentet te cilat i kemi ngarkuar dhe derguar sipas kërkeses për sqarim janë dokumente origjinale te cilat janë të nënshkruara dhe vulosura nga N.N.T "BURIMI" & HIDRO PROJECT SHPK dhe kanë përmbajtjen e njejtë duke mos ndryshuar asgjë materiale e të cilat nuk i kontestuar as AK.

Dokumentet të cilat i kemi dorzuar ditën e hapjes, pra me datë: 16.09.2021 janë të gjitha origjinale dhe as këtë nuk e ka kundershtuar AK. Problemi me AK është se përse këto dokumente nuk janë sjellur identike me dokumentet e dorzuara në ofertë pas kërkeses për sqarim?

Me datë 18.10.2021 është kërkuar qe këto dokumente të sillen në menyrë fizike qe të verifikohen dhe për atë qellim edhe i kemi sjellur me mendimin qe ti hekum dyshimet se nenshkrimi dhe vula i takojn te dy operatorëve ekonomik. Këtë nuk e ka kontestuar AK. Më thënë të drejten ne me shumë deshir e kemi bërë një gjë te tillë (dorzimin e dokumenteve në formë fizike dhe elektronike) për shkak se ndodh se shumë herë kur skenojm dokumente te tilla nuk duken edhe shumë qartë dhe mund të lindin dyshime.

Marrëveshja e konzorciumit dhe dokumentet e tjera qe janë kërkuar për sqarim është fakt qe janë të ngarkuara ditën e hapjes se ofertave dhe se janë origjinal dmth janë dokumente te cilat kanë ekzistuar.

Më thënë me qart dhe më shkurt ne e kuptojm kështu:

Në momentin qe AK ka dyshuar në nenshkrime dhe vula, atëher ne duhet qe ti sjellim dokumentet po më të njejtin nënshkrim dhe vulë dhe të cilat prap po themi qe nuk i ka kontestuar AK por është krijuar edhe një problem nga vet AK

qe pastaj na ka eleminuar me arsyetimin qe nuk janë identike. **AK pas kërkesës për sqarim, ka pranuar nga ne te gjitha dokumentet e kerkuara origjinale, te cilat nuk kanë pasur asnjë ndryshim material dhe asgjë jashtë kërkesave të DT por gjithmonë në harmini me DT.** Kështu e kuptojm ne, dhe në bazë të kësaj ne prap mendojm se AK ka bërë shkelje në lidhje me eleminimin tonë edhe përkunder qe kemi qenë me qmim me të lirë (kusht për dhënje të kontratës).

1. **Nuk është respektuar Neni 7 pika 1 e LPP-së, (Autoriteti kontraktues do ti trajtoj OE në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.**

   Përgjigjja qe ka dhënë AK me datë: 15.11.2021 mbi refuzimin e kërkeses për rishqyrtim me tepër i ngjan një shkrese personale sesa një shkrese zyrtare.
   Ky nuk ka të bëjë me trajtim të barabartë kur AK me qdo kusht mundohet te krijoj probleme qe nuk kan ekzistuar dhe te arsyetohet për eleminimin e OE.
   Sa i përket trajtimit të barabartë dhe jo-diskriminues mendojm se është shkelur ligji si i tillë dhe le ta gjykon OSHP-ja meqenese këtë ankes po e bëjm për këtë qellim.

   Tani po vazhdojm t'i përmendim shkeljet qe ka bërë AK

2. **Nuk është respektuar Neni 59 - LPP-së (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve).**

   AK nga pikat qe ka përmendur është edhe ajo e nenit 32.3 me të cilën thotë se ne i kemi ikur me qellim disa pikave te një neni tjetër pasiqe nuk na paska konvenuar(gjithmon sipas AK).
   Nuk mund ta kuptoj se si mund te mendohet një gjë e tillë kur LPP dhe Rregulloret janë publike për secilin dhe se secili mund ti posedoj. Nga kush mund t'i fshehim ato?
   Në këtë pjesë po folim lidhur me atë se qfarë ka shkruar AK në përgjigjen e kërkeses për rishqyrtim.

   Si fillim, e para: **Neni 32 i RRUOPP Dorëzimi i tenderit ne forme fizike.** Vetë titulli i nenit po tregon qartë se me qfarë kemi të bëjm. Tenderet janë dorzuar në formën elektronike përmes e-prokurimit dhe nuk është e cekur askund se ky AP dorzohet në formen fizike.
   E dyta: **32.3 Tenderi do të dorëzohet të AK në një formë të origjinalit dhe një numër të kopjeve të cilat AK i ka kërkuar në mënyrë të qartë në dosjen e tenderit. Tenderi origjinal si dhe kopjet e kërkuara do të jenë identike. Kopjet hapen ne shërbim të komisionit vlerësues.**
   Atëher le te na tregoj AK se në cilën pjesë të DT e ka kerkuar një numer të kopjeve pasiqe qe ketu po shenon qartë se është dashur t'i kërkosh ne dosjen e tenderit. Edhe diqka, na trego se a kanë sjellur kopje te tenderit OE te tjerë ekonomik për këtë AP meqenese fjalia e fundit i keti neni thotë kështu: **Kopjet hapen ne shërbim të**

**komisionit vlerësues.** (fjali e cila është hequr nga neni në fjalë nga Menaxheri i prokurimit).
Ne ende nuk e kuptojm se si AK bazohet ne nenin 32 të RRUOPP kur ofertat janë dorzuar në platformen elektronike e-prokurimi ndersa në DT nuk është cekur askund se ky AP dorzohet në formën fizike e aq me pak ne një numer te kopjeve.

1. Me rastin e eleminimit nga AK, në njëren anë ka thënë se ne nuk i kemi paraqitur dokumentet me numer rendor 4.1 (shiqo me lart) gjë e cila nuk është e vertet sepse të gjitha dokumentet janë dorzuar në ofertë përmes e-prokurimit dhe mund te shihen qart, dhe në anën tjeter ka thënë se ne i kemi paraqitur këto dokumente pas kërkeses për sqarim por se nuk janë identike me dokumentet te cilat i kemi ngarkur në e-prokurim diten e hapjes( duke u bazuar edhe ju në nenin 32, paragrafi 32.3 të RRUOPP) i cili nuk ka të bëjë më këtë procedur të prokurimit meqenese ofertat janë dorzuar në sistem elektronik E-prokurimi. Dmth kjo nuk qendron.

AK është bazuar në nenin 72 të LPP përkatesisht paragrafi 3 i cili thotë: Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.
Informacioni në rastin tonë nuk mungon sepse të gjitha dokumentet janë të ngarkuara në sistemin e e-prokurimit diten e hapjes(origjinal) dhe dokumentet për sqarim te tenderit qe keni kërkuar janë dorzuar po ashtu brenda afatit kohor me datë 19.10.2021 e të cilat kanë ekzistuar në dosjen e tenderit.

AK nuk është bazuar në nenin 72, paragrafi 1. i cili e sqaron këtë situat. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

Ky nen dhe paragraf e sqaron në menyrën me të mirë rastin tonë sepse pas kërkesës për sqarim, ne i kemi sjellur dokumentet e kërkuara në formën te cilën janë kërkuar pra në formë fizike - origjinale. Lidhur më këto nuk ka pasur ndonje vërejtje nga AK. **Është shkelur neni 72. Paragrafi 3**

Gjithashtu AK është bazuar në nenin 59, pika 2 të LPP i cili thot: Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

Pas kërkeses për sqarim ne kemi dërguar të gjitha dokumentet e kërkuara për ekzaminim, vlersim dhe krahasim (kur themi "krahasim" verehet qartë se nuk janë krahasuar dokumentet e ofertës me dokumentet e dërguara pas kërkeses për sqarim dhe si pasoj nuk ka as vlersim e as ekzaminim) dhe të cilat nuk kanë pasur asnjë ndryshim material.

Pra neni 59. Pika 2 në të cilin është thirrur AK është shkelja tjetër qe kanë bërë në rastin tonë.

2. **Sa i përket pikes 2 për të cilën jemi eleminuar, konkretisht: Ne jemi eleminuar sepse në deklaraten nën betim të anëtarin të konzorciumit nuk shenon emrin i AP dhe numri i prokurimit, dhe jemi eleminuar në bazë të nenit 59. Pika 2 dhe neni 72, paragrafi 3. I LPP-së**

Deshmia ma e mir se ne kemi aplikuar për këtë AP është marrëveshja e konzorciumit në të cilen ceket saktë AP dhe numri i prokurimit dhe AK, gjithashtu kemi aplikuar si grup ne sistemin e-prokurimi. Me këtë rast po i përmendim edhe disa fakte te tjera.
Në RRUOPP brenda nenit 40.3 shkruan kështu: Secili anëtar do të nënshkruaj deklaratën duke përdorur formën standarde të aprovuar nga KRPP **"Deklaratën nën Betim"** që deklaron që ai/ajo do të kryej detyrën e vlerësimit në mënyrë të sinqertë dhe me fisnikëri në pajtim me LPP. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës për sa i përket vlerësimit teknik të ofertës.

Kur AK thotë se në deklaraten nën betim të anëtarit të konzoriciumit HIDRO PROJECT SHPK nuk figuron emri i AP dhe nr.i prokurimit, ne e kemi një pytje për AK :
Në deklaraten nën betim qe e përdorin anëtarët e komisionit për vlersim, a mund te na tregoni se përse nuk figuron AP dhe Nr.i Prokurimit?
Këtë e shohim edhe ne në Legjislacionin sekondar, përkatesisht D03 Deklarata nën Betim për anëtarët e komisionit vlersues.
Prandaj nuk është aspak e ndershme të kërkohet një gjë e tillë të cilen AK e ka kërkuar duke e pasur te qart se ajo Deklaratë nën Betim ka ardhur pikerisht për AP në fjalë.

Më këtë rast po jua përcjelli përgjigjen e KRPP-së në pytjet e shpeshta (Pyetja 72) qe e sqaron në mënyrë të qartë pikërisht këtë problem e të cilin po jua përkujtojm:

**"Deklarata nën betim" është kusht administrativ dhe dëshmi që kërkohet sipas nenit 65 të LPP-së për të dëshmuar përshtatshmërinë e OE-së për pjesëmarrje në aktivitetin aktual** të prokurimit (pra që është në fazën e tenderimit) dhe si e tillë ajo nuk mund të kërkohet në bazë të nenit 72 të LPP-ës, ngase ekzistenca e saj (pra e deklaratës nën betim) nuk mund të verifikohet në mënyrë objektive nga AK siç e kërkon paragrafi 3 i nenit 72 të LPP-ës.

Pra me një fjalë, deklarata nën betim **nuk** është një dokument i cili e plotëson kërkesën e paragrafit 3 të nenit 72 të LPP-ës, për këtë arsye, **Deklarata nën betim, duhet të nënshkruhet vuloset dhe** duhet të dorëzohet së bashku me tender para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve të specifikuar në Dosjen e Tenderit.

AK me mburrje tregon se si kjo pytje është bërë për një qeshtje tjeter e jo për rastin ton konkret.

KRPP po e qarteson se deklarata nen betim nuk mund të kërkohet në bazë të Nenit 72 të LPP-së, nen ky mbi të cilin jemi eleminuar. Dmth nuk ka të bëjë me pytjen por me thelbin të cilin e sqaron LPP-në nga KRPP-j. Gjithashtu deklarata nën betim(sipas sqarimit të KRPP-së) nuk është një dokument I cili ploteson kërkesën e paragrafit 3 të nenit 72 të LPP-së.

Pra Deklarata nën betim nga ana e HIDRO PROJECT SHPK është e nënshkruar, vulosur dhe dorzuar në origjinal dhe është dorzuar se bashku me tender me datë: 16.09.2021

Nuk e kemi pasur një problem te tillë me herët por vetëm tani, meqenese ligjet dhe rregulloret e prokurimit janë të njejta për të gjitha institucionet.

3. Gjithashtu AK na ka eleminuar sepse, citoj: "vendimin për caktimin e menaxherit të projektit është kërkuar origjinal në menyrë qe të verifikohet dhe pas dorzimit të origjinalit është konstatuar se nuk është në përputhje apo identike me dokumentet e dorzuara në ofertën tuaj andaj aleminoheni në bazë të nenit 59, pika2 dhe nenit 72 paragrafi 3."

   Po e perserisim, pasi ju keni bërë kërkesën për sqarim, datë 18.11.2021 lidhur me dokumentet me numer rendor 4.1 (shiqo ne fillim) përfshir edhe vendimin për caktimin e menaxherit të projektit i kemi sjellur në menyrë fizike dhe origjinale ashtu siq edhe je pajtuar se janë origjinal, citoj"pas dorzimit të origjinalit",dmth edhe vet AK pajtohet qe dokumentet kanë qenë origjinal por jo identike dhe këtu po bini në kundershtim pikerisht me nenin 59 dhe 72 sepse dorzimin e dokumenteve e kemi sjellur dhe ngarkuar në e-prokurim pikërisht ashtu siq e keni kërkuar. Meqenese jemi këtu vlen te ceket se Kërkesa për sqarim pranohet vetem permes platformes elektronike e-prokurimi ndersa ne e kemi dorzuar edhe fizike.
   39.8 AK duhet të dërgojë "Kërkesë për sqarim të tenderit" OE përmes sistemit të prokurimit elektronik, dhe OE duhet të dorëzojë përgjigjen e tyre tek AK në një dokument të shkruar me anë të sistemit elektronik. Nënshkrimi digjital nuk është i obligueshem deri ne njoftim zyrtar nga KRPP

Pra neni 59. Pika 2 në cilin jeni thirrur është shkelja tjetër qe keni bërë në rastin tonë.

**Në mes shumë neneve dhe ligje qe ka shkelur AK gjithashtu ka shkelur edhe nenin 43 të RRUOPP-së, pika** 43.1 Të gjithë tenderuesit / kandidatët duhet të informohen nga AK, përmes publikimit të Formularit B58 - Njoftimit mbi Vendimin e AK, pa vonesë, ne platformën elektronike si dokument shtesë nëpërmjet funksionit Dosja e Tenderit - "shtoni dokument të ri"
*(Njoftimi i KRPP-së Nr. 91/2018, i dt. 26.12.2018)* , prandaj edhe Kërkesa për rishqyrtim pranë AK-së si dhe Vendimi i AK-së duhet të komunikohen përmes platformës elektronike.
Si rrjedhojë,
Për të gjitha rastet "Vendimi i lëshuar" nënkupton Vendimin e ngritur në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik nga ana e AK-së. Operatoret Ekonomik dhe/ose palët e interesuara do të konsiderohen " Të njoftuar" nga momenti kur AK e ngritë Vendimin në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik.
Po e qartësoj, AK përkatesisht Menaxheri i Prokurimit Besim Mulaj me datë: 05.11.2021 ka ngarkuar në e-prokurim B36 Raportin e vlersimit të tenderëve po nuk ka ngarkuar B58 Njoftimin për vendimin e AK i cili duhet ngarkuar menjehere pas raportit të vlersimit te tenderëve. Me datë 08.11.2021 pasi ju kemi shkruar e-mail për gabimin qe ka bërë, Menaxheri i prokurimit me datë: 09.11.2021 ka ngarkuar B58 Njoftimin mbi vendimin e AK ndërsa datën e njoftimit ka mbetur 05.11.2021 qe do të thot ka shkelur nenin ne fjalë duke na lënë vetëm 1(një) ditë afat për ankes për rishqyrtim. Rrjedhimisht AK e keni fshehur B58 Njoftimin per vendimin e AK duke mos e publikuar por duke i llogaritur ditët për ankes.
Ne për aq sa kemi informacion nuk mundemi qe përmes raportit të vlerimit te shkruajm kërkes për rishqyrtim.

**SI PËRFUNDIM**

Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim është shkresë më shumë personale sesa zyrtare dhe kuptohet se meniher këtu është keqkuptuar edhe kërkesa për rishqyrtim. Ne nuk kemi pasur qellim asnjëher dhe në asnjë formë qe kërkesën për rishqyrtim ta drejtojm nga personalja por duke gjetur shkeljet qe janë bërë jemi munduar qe ti sjellim argumentet tona. Pra nese kur përmendet emri i menaxherit të prokurimit po u vlersojka si personale atëherë është problem i menaxherit të prokurimit dhe jo neve.

Është e pakuptimt dhe për keqardhje se si AK bazohet nganjeher në "Logjikë" dhe përmend fjalë të urta popullore në një qeshtje serioze duke harruar qeshtjen për të cilën flitet.
Meqenese nuk kemi pasur asnjehere një problem te tillë ne po i drejtohemi OSHP-së në menyrë qe ta kemi te qart ne si OE sesi veprohet në këtë rast. Nuk po bëjm ndonjë krim por vetem deshirojm qe te qartesohemi, mendojm qe është e drejtë e jona qe të marrim një përgjigje në menyrë qe tjera here ti kemi gjërat shum te qarta.

AK në përgjigjen e kërkeses për rishqyrtim ka thënë se ne (OE) kemi qellim vetem te bëjmë ankesë për shkakë të mosfunksionimit të OSHP-së. Nuk është e vertet sepse edhe heren e kalur në një procedur tjeter kemi bërë ankes dhe AK (AMKMK) e ka kthyer si te bazur duke na rekomanduar për kontrat. Nuk jemi OE qe bëjmë gjëra te tilla po meqenese Menaxheri i prokurimit Besim Mulaj e lejon veten te shprehet keshtu dhe ta kthej ne personale qe ta mbroj veten, atëhere po ja lajm në dorë OSHP-së qe të vendos në lidhje me këtë AP.

Meqenese AK na sygjeron qe ta pyesim KRPP-në në lidhje me këtë, ne po themi se nuk mund t'i drejtohemi KRPP-së për qdo problematik sepse ligjet dhe rregulloret kanë dal prej vetë KRPP-së te cilat janë shumë te qarta.

AK thotë se, citoj: "Ne nuk e kemi kontestuar se ato dokumente ndryshojn në përmbajtje por të thuhet se nuk ndryshojn nga ato te dorzuara në ofertë kjo nuk qendron sepse ato nuk janë dokumentet te krijuara dhe nuk janë të njejta me ato te dorzuara në ofertën tuaj".
Po e saktesojm atë qe kemi thënë ne në këkesën për rishqyrtim: "Të gjitha dokumentet e dorzuara pas kërkeses për sqarim janë në përmbajtje të njejta dhe origjinale(gje te cilen ti nuk e ke kontestuar) **dhe nuk ndryshojn asgjë nga përmbajtja e dokumenteve të dorzuara në ofertë dhe se nuk ka asnjë ndryshim material".**
Nga kjo shohim se ne kemi thënë "nuk ndryshojn asgjë nga përmbajtja e dokumenteve të dorzuara në ofertë". Më këtë rast kërkojm qe se paku te na interpretohen fjalët ashtu siq kemi thënë. **Sqarim**: Kur themi "përmbajtjen" kuptojm përmbajtjen tekstuale qe i përket AP në fjalë, marrëveshja e konzorciumit, AK, Titullin e projektit, nr.prokurimit, dhe gjitha të tjerat qe janë kërkuar në DT e të cilat i kemi dorzuar. Nese AK e kupton "përmbajtjen" se vula dhe nënshkrimi duhet të jenë në te njejtin vend, atëhere pikerisht ky është problemi dhe thelbi kryesor pse ne kalojm me ankes në OSHP.
Pikërisht nga ky rast është përmendur Forenzika (nuk mund te aludojm nese është kercnim apo jo) por meqenese AK është shprehur se, citoj: "Ne rast se ju nuk bindeni ne mund te kërkojm nga Forenzika për të verifikuar..."
Ne nga sot po themi se të gjitha dokumentet qe janë kërkuar në kërkesën për sqarim janë origjinale dhe kanë përmbajtjen e njejtë(dmth kanë të bëjnë me të njejten AP) ashtu siq AK i ka kërkuar dhe do ta themi përseri sa herë te jetë e nevojshme.

Sa i përket fjalve popullore, sinqerisht nuk e kemi pritur një nivel kaq te ulet të përgjigjes ne kërkesen për rishqyrtim por kjo le te mbetet mbi poziten dhe etiken e secilit. Nuk do merremi më këtë pjesë sepse qeshtja ne thelb është shum me rendesi për ne sesa fjalet e urta popullore, pra do vazhdojm te merremi me atë qe na takon e jo me atë qe nuk na takon.
Edhe diqka ne lidhje se nga e kemi marr informacionin qe po perdorni standarde te dyfishta. Po e sqarojm:
E para: Çdo OE për secilen AP mund të interesohet përmes platformes elektronike e-prokurimi dhe secili njoftim apo vendim i AK na krijon mundesin qe ta shohim edhe ne duke përfshir edhe arsyet e eleminimit te OE dhe qdo njoftim qe shfaqet.
E dyta, ne OE bashkëpunojm njeri me tjetrin dhe gjithashtu i shtjellojm problemet dhe te mirat tona se si një procedur është dhënë me kto kushte apo me kushte te tjera dhe pikerisht ketu buron informacioni. Nuk është asgjë e kunderligjshme apo jo.
T'i thuash OE nga i merr informacionet në lidhje me aktivitete te prokurimit, kur çdo gjë tani është elektronike dhe publike, nuk ka fare kuptm dhe me këtë po aludon ne diqka te cilen ne nuk e dim.
Nese AK mendon qe ne kemi marrur informacione ne një menyr tjetër atëher le të na tregon se nga i paskemi marrë ato informacione, por mendojm se nuk ka fare rendesi kjo.

Realisht dhe përfundimisht kur folim për dokumentet me nr. rendor 4.1, nuk ka pasur asgjë të pakuptueshme dhe dyshuese, por meqenese AK ka insistuar për të na eleminuar, te shohim se qfar mendimi ka OSHP për këtë AP.

Sidoqoftë, ne kërkojm vetëm dy gjëra nga OSHP-ja:

1. **Interpretimin e drejt të LPP-së dhe rregulloreve dhe**
2. **Trajtimin e barabartë, të drejt dhe jo-diskriminues**

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

*a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*

*b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*

*c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*

*d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*

*e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*

*f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*

*g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*